



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.539/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.02.2025, merr këtë :

VE N D I M

- I. PRANOHET E BAZUAR** ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, Anr.539/2025 datë 10.02.2025.
- II.** Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 1,500.00 Euro (Njëmijepesëqind) euro.
- III.** Detyrohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Komuna Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 10.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën Anr.539/2025, nga subjekti politik LVV në të cilën thekson se më datë 09 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Drenas, gjatë monitorimit të ditës së zgjedhjeve, ka identifikuar një fotografi të publikuar në facebook nga Selman Qallapeku, këshilltar komunal në Komunën e Drenasit, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës së bashku me një numër të konsiderueshëm të njerëzve, gjatë kohës kur është e ndaluar çdo formë e fushatës, konkretisht në ditën e zgjedhjeve pas hapjes së Vend Votimit. Kjo fotografi është e shoqëruar me numrin e subjektit politik PDK (131) dhe është bërë me qëllim të promovimit të subjektit politik dhe ndikimin tek votuesit. Konsiderojmë se një veprim i tillë, i zyrtarit të PDK-së dhe i subjektit politik PDK, bie ndesh me nenin 37 paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe Neni 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1. i Rregullores Zgjedhore NR. 07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, me çka ka

tentuar që në ditën e zgjedhjeve të ndikoj tek votuesit kundërligjshëm. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës si provë linkun i fotografisë si dhe fotografia e publikuar në profilin e facebook:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=4247720075462240&set=a.1904096953157909>

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik PDK për rastin Anr.539/2025 thuhet se PDK përmes kësaj përgjigje, kërkon nga PZAP që ankesën e ankuesit t'a refuzoj si të pabazuar për arsye se PDK me rastin e shikimit të profilit të z. Selman Qallapeku nuk ka arritur të identifikoj ndonjë përshkrim siç pretendohet me ankesë në postimin e publikuar nga i njëjti, andaj e kemi të pamundur të deklarohe mi në lidhje me këtë pretendim, për faktin se nga shikimi i profilit të z. Selman Qallapeku nuk vërehet ndonjë shenjë e cila do të mund të kuptohej si bërje e fushatës me qëllim të promovimit të subjektit politik PDK. Si më sipër, në rrethanat e rastit konkret, përmes këtyre veprimeve, PDK nuk është përgjegjëse për shkelje të rregullave të përcaktuara në Rregulloren Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Reklamimin Financiar si dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se :

-Ankesa është bazuar.

Paneli, pas shikimit shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale nga subjekti politik LVV ka gjetur se nga këshilltari komunal në Komunën e Drenasit, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, Selman Qallapeku, me qëllim të bërjes së fushatës zgjedhore gjatë ditës së votimit ka postuar fotografi në rrjetin social facebook, me numër 131, me qëllim të promovimit të subjektit politik PDK dhe ndikimit tek votuesit, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 37 paragrafi 1 dhe 2 i LZP-së në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit; bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”, si dhe në nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1. të Rregullores Zgjedhore NR. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve, dhe Reklamimin Financiar si dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: 1.Nga hapja e qendrave të votimit për votim dhe deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike dhe përfaqësuesve të tyre u ndalohen veprimet më poshtë: 1.1. Mbajtja e takimeve për qëllime të fushatës së zgjedhjeve apo grumbullimi i zyrtarëve të subjektit politik të certifikuar në afërsi të qendrave të votimit “, andaj Paneli gjeti se veprimet e tilla janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe nga këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik PDK, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, ku nga kjo përgjigje ky subjekt e mohon shkeljen e bërë dhe thekson se nuk ka arritur të identifikoj ndonjë përshkrim siç

pretendohet me ankesë në postimin e publikuar nga i njëjti, andaj e kemi të pamundur të deklarohe mi në lidhje me këtë pretendim, për faktin se nga shikimi i profilit të z. Selman Qallapeku nuk vërehet ndonjë shenjë e cila do të mund të kuptohej si bërje e fushatës me qëllim të promovimit të subjektit politik PDK, dhe se PDK nuk është përgjegjëse për shkelje të rregullave të përcaktuara në Rregulloren Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Reklamimin Financiar si dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nënin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.539/2025 datë 13.02.2025



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform neni 118 paragrafi 4 të LZP-së.